



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit  
Opština Gnjilane  
Municipality of Gjilan  
Gilan Belediyesi

Njësia për Sport /Jedinice za Sport/Departament of Sports

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:		z.Lutfi Haziri, Kryetar i Komunës së Gjilanit			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		z.Malazog Hoxha, Udhëheqës i Njesisë së Sportit			
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:		Raporti i Njesisë për Sport			
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. Kancelarije:		Lokacija:		Date:	28.06.2016
Room No:		Extencion:			

## Raporti i Njesisë së Sportit

Njësia për Sport duke pasur parasysh morinë e madhe të ngjarjeve, aktiviteteve si ato ditore, mujore, dhe vjetore në vazhdimësi, ne do të paraqesim këtë informata të të gjitha ngjarjet/aktivitetet me rëndësi të posaqme që janë zhvilluar duke i trajtuar veç e veç .

Komuna e Gjilanit tanimë shquhet për organizimin e veprimtarive sportive që janë të shumta dhe të ngjeshura, si sektori i Sportit edhe pse në këta muaj pushimi dimeror , kemi bërë përpjekje që të përballemi edhe pse me vështirësi duke pasur parasysh problemet dhe nevojat e shumëta të klubeve sportive për ndihmë financiare si dhe infrastrukturë sportive .

Vlenë të ceket se me datë 23 Shkurt 2016, pas kryerjes së punimeve të stadiumit ndihmës, Kryetari i Komunës si dhe përfaqësuesi i Komisionit European bënë inaugurimin e Stadiumit ndihmës, donacion i Bashkimit European me dimensione UEFA-së dhe FIFA-së dhe një prej Stadiumeve me të mira në Kosovë pasi që i vetmi posedon stazë të Atletikës.

Në muajin Shkurt kemi bërë marrveshje me Drejtorine e Arsimit që të gjitha shkolla të cilat posedojnë salla sportive që të mundë ti shfrytëzojnë jashtë orarit të mësimi.

**Klubet të cilat kanë nënshkruar marrveshje për shfrytëzimin te këtyre hapësirave sportive janë :**

1. Klubi i Volejbollit "Drita"(f)
2. Klubi i Basketbollit "Drita"(f)
3. Klubi i Karatesë "Drita"
4. Klubi i Karatesë "Dardania"
5. Klubi i Karatesë "Elita"
6. Klubi i Karatesë "As"
7. Klubi i Karatesë "Katana"
8. Klubi i Xhudos "Gjilani"
9. Si dhe Organizata e Kujdesit ditorë për fëmijë me nevoja të veqanta

**Në fillim të muajit Mars kemi bërë ndarjen e karrigave të cilat kanë qenë donacion nga Federata e Futbollit të Kosovës për të gjitha shkollat e fshatrave të Komunës sonë ku përfitues të këtyre karrigeve kane qenë Shkollat :**

- Shkolla "Agrim Ramdani" Zhegër
- Shkolla "Skenderbeu", Përlepnice
- Shkolla "Ramiz Cernica" , Cernice
- Shkolla " Mulla Idriz Gjilani" Velekincë
- Shkolla " Dëshmorët e Kombit" Livoq i Epërm
- Shkolla "Vatra e Diturisë" Livoq i Ulët
- Shkolla "Esat Berisha" Llashticë

**Më 13 Mars 2016 është mbajtur manifestimi ndërkombëtarë në Atletikë Pranvera Studentore e viti 1981 "Vrapimi i Qytetit Gjilani 2016".**

Në këtë manifestim që ishte ndër manifestimet më masovike ku pati numër rekord të garuesve ishin mbi 300 Atlet, ku pjesëmarrës ishin Atlet nga Kosova, Shqipëria si dhe Maqedonia.

Për tu organizuarr ky manifestim ndërkombëtarë në Atletikë, kësaj radhe kosto e vrapimit ka qene më e ulët falë një dashamiri i cili jeton në boten e jashtme e i cili u perkujdes që ta mbulojë Akomodimin për vrapuesit nga Shqipëri si dhe për darken e përbashket në fund të manifestimit.

**Buxheti financiar për këtë aktivitet ka qenë :**

- 1.Qmimet për vrapuesit,medaljet,kupat, referet,numar,informimi, si dhe gjerat tjera për rrjedhjene e aktivitetit 1700 €
- 2.Ansambli për perkujdesjen në aktivitet 150 €
- 3. Zërimi për hapjen e aktivitetit 85 €
- 4. Darka dhe akomodimit për musafirët 400 €( darka dhe akomodimi është mbuluar nga një qytetar i cili jeton ne boten e jashtme)

**Më 14.03.2016 është mbajtur dëgjimi publik për ndryshimin,plotësimin dhe harmonizimin e rregullorës për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.**

Tarifat për shërbimet që ofrohen për shfrytëzimin e stadiumit ndihmës të Qytetit dhe fushës sportive në Dardani nga shkollat e regjistruara të futbollit, nga qytetarët dhe klubet sportive jashtë komunës.

- 8.1. Për stërvitje të shkollave të futbollit 30 €/1.5 orë
- 8.2 Për lojë të futbollit për tri grupmoshat 50€/ 3 orë
- 8.3.Shfrytëzimi i stazës(trakes) së Atletikës nga qytetarët 5€ /mujore
- 8.4. Stërvitja nga shkollat e futbollit me reflektorë tarfi shtesë 10 €
- 8.5.Për lojë miqësore me klube jashtë Qytetit 50 €
- 8.6. Për lojë futbollit në terrenin sportiv në dardani pa reflektor 8 €/ 1orë
- 8.7.Për lojë futbollit në terrenin sportiv në dardani me reflektor 12€/1 orë

**Me që klubet tona kane filluar sezonin, pararelisht me shum veprime tjera të cilët e bëjnë të mundshem funksionimin sa më të mirë të këtijë sezoni për Klubet e Sportit në Komunën tonë, ne si Njësi për Sport kemi përgatitur një listë për subvencionimin e klubeve varësisht për nga rangu ku garojnë ato.**

Kemi rreth 20 klube të cilat i subvencionojme për këtë vit dhe kemi nenshkrur

marrveshje bashkëpunimi në mes klubeve-organizatave si dhe Komunës sonë. Klubet të cilët do të përfitojnë subvencion nga Komuna janë :

	<b>Emri i Klubit</b>	<b>Rangu</b>	<b>Shuma</b>
1	Klubi i Futbollit "Drita"	Superligë	33.000 €
2	Klubi i Futbollit "Gjilani"	Superligë	30.000 €
3	Klubi i Basketbollit "Drita"(m)	Liga 1 (Pretendet për Superligë-vendi 1)	8.000 €
4	Klubi i Volejbollit "Drita"(f)	Superligë	10.000 €
5	Klubi i Hendbollit "Drita"(m)	Superligë	4.000 €
6	Klubi i Hendbollit "Drita"(f)	Superligë	4.000 €
7	Klubi i Hendbollit "Zhegra"	Superligë	4.000 €
8	Klubi i Futbollit Femra "Intelektualët" (f)	Superligë	3.000 €
9	Klubi i Futbollit "Bashkimi"	Liga 2	2.000 €
10	Klubi i Futbollit "Galaksia"	Liga 2	2.000 €
11	Klubi i Basketbollit "Drita"(f)	Superligë	2.000 €
12	Klubi i Boksit "Drita"	Superligë	3.000 €
13	Lidhja Rajonale e Futbollit-Gjilan		Xx
14	Shoqata Pedagogëve të Sportit Shkollor		3.000 €
15	Moto-Klub "Uglari"		1.500 €
16	Klubi i Karatesë "Dardania"		1.500 €
17	Klubi i Karatesë "Elita"		1.500 €
18	Klubi i Karatesë "AS"		1.500 €
19	Klubi i Karatesë "Drita"		1.500 €
20	Klubi i Futsallit "Perlepnica"	Superligë	1.500 €

**TOTALI :117.000**

### **Stadiumi i Qytetit**

Para fillimit të sezonit pranveror, për ta bërë të mundshëm fillimin e këtij sezoni për Klubet e Futbollit në Komunën tonë, ne si Njësi për Sport jemi përkujdesur që ta rregullojmë gjendjen në këtë Stadium ku fillimisht kemi bërë:

- Konzervimin e Stadiumit të Qytetit
- Kemi rregulluar të gjitha hyrje-daljet me skajore
- Gjithashtu kemi aftësuar stazen e stadiumit duke vendosur zhavor.

### **Palestra Sportive**

Gjatë kësaj kohe përveq stërvitjeve të rregullta kemi patur gjithashtu edhe **51** aktivitete tjera, si sportive por edhe evenimente tjera

Gjatë muajit janar nuk kemi patur shum aktivite sportive, pasi që klubet kanë qenë në pushim.

Me 2 prill, ne ditën e tokës, në bashkëpunim me gjithë stafin e Njesisë së Sportit (palestren, stadiumin) kemi organizuar pastrimin e oborrit të palestres, ku kemi bërë prerjen e të gjithë drunjve dhe kemi rrafshuar disa pjesë të dheut me eskavator.

Gjatë muajit shkurt në palestër klubet sportive kanë zhvilluar aktivitetet e tyre të stërvitjeve dhe garave sipas orarit të përcaktuar bashkërisht. Aktiviteti gjatë kësaj periudhe ka filluar të shtohet për shkak që klubet kanë zhvilluar intensivisht stërvitjet për shkak të garave kampionale.

**Më datë 29 Maj,** në bashkëpunim me Rotarianët e Rinjë, si dhe Shoqatën e Refereve të Gjilanit kemi organizuar një turnir humanitarë në Futboll me qëllim të sigurimit të fondeve për ti dalë në ndihmë familjeve me nevojë.

Ne si Njësi për Sport kemi siguruar hapësirën sportive në lagjen Dardania kemi ndihmuar në udhëheqjen e turnirit si dhe i kemi siguruar rekuizitat sportive, ndërsa Shoqata e Refereve ka asistuar me katër refer (pa pagesë).

Fondi i cili është grumbulluar nga ky turnir ju është ndarë familjeve me nevojë në muajin e shenjt të Ramazanit (pako ushqimore)

**Në muajin Maj 2016,** kemi filluar rinovimin e palestres së sportëve në të gjitha hapësirat e saja, si brenda ashtu edhe jashtë sajë. kemi bërë lysterjen e mureve, rregullimin e nyjeve sanitare, ndriqimin më ekonomik, rregullimin e dyerve, rregullimin e sallës së boksit si dhe shumë gjëra tjera brenda.

Në hapësirat e jashtme kemi filluar ta pastrojmë oborrit, ti rrenojmë disa objekte të panevojshme që kanë shërbyer për dukuri negative, kemi kthyer gjendjen normale në të gjithë hapësirën e jashtme të këtij objekti sportiv.

Njesisë për Sport i janë shtuar edhe dy fusha Sportive, Stadiumi ndihmës si dhe fusha në lagjen Dardania, kemi bërë riorganizimin e stafit dhe me të njëjtin staf kemi duke i mbajtur edhe këto dy objekte Sportive.

Gjithashtu vlen të theksohet se pas gjendjes jo të mirë në inkasim të rekreacionit kemi angazhuar personin adekuat që ta udhëheqë rekreacionin në pallatin e sporteve.

Me angazhimin serioz nga Janari i këtij viti kemi rritur inkasimin e rekreacionit nga 100 sa ka qenë të inkasuara në një mesatare, nga kjo kohë kemi shtuar inkasimin në 500 në muaj, ku prej Janarit vetëm në Palester kemi inkasuar afro 3.000 €.

**Gjithashtu edhe ne objekte** tjera si Stadiumi Ndihmës kemi filluar inkasimin si dhe në fushen e Lagjës Dardania ku mesatarja në muaj të këtyre objekteve arrin shumën 1300 €, ku në muajt ne vijim mendojmë që këto të hyra ti shtojmë deri në 2.000 € për një muaj.

**Në muajin Qershor**, më qëllim të avansimit të vlerave të mirëfillta sportive, Njësia për Sport, duke përvijuar një traditë vjetore edhe sivjet ka shpallë sportistët dhe subjektet më të sukseshme gjatë periudhës Qershor 2105, Qershor 2016.

Për të qenë sa më profesioanal dhe për tu shperblyer në mënyrë sa më meritore për të arriturat e tyre, ne si Njësi për sport, pran KK-Gjilan, kemi formuar komision profesional për shpalljen e Laureatëve ku pjesë e këtijë komisioni ishin :

1. Malazog Hoxha
2. Rifat Shabani
3. Hafiz Gashi
4. Arben Maliqi
5. Agim Latifi
6. Veton Xhemajli
7. Sylejman Ismajli

**Buxheti financiar i këtijë evenimenti është :**

- Kokteji për pjesëmarrësit- 900 €
- Medaljet për Sportistët 500 € si dhe
- Shtypja e një baneri 58 €

**Në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, për herë të parë në Gjilan më datë 23 Qershor, është organizuar Panairi i Sportit Gjilani 2016.**

Në ciliësinë e udhëheqësit të Njesisë së Sportit të Komunës së Gjilanit, shprehë konsideraten time të lartë për pjesëmarrjen në Panairin e Sportit në Gjilan.

Bazuar në rekomandimet e lëshuara nga KOK-i, ne me një përkushtim të madh jemi munduar që ti realizojmë sugjerimet të cilat kanë ardhur për këtë aktivitet. Nga vlerësimet të cilat kanë ardhur nga profesionist dhe pjestarë të mediave, konsiderojmë se aktiviteti është kryer me sukses.

Këtë konstatim e bazojmë në të dhënat të cilat i posedojmë si Njësi e Sportit, e që ju lusim ti shihni në vazhdim:

Të pranishëm në Panairin e Sportit në Gjilan kanë qenë Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Lutfi Haziri si dhe Kryetari i Komitetit Olimpik te Kosovës z.Besim Hasani si dhe klubet e futbollit, volejbollit, ping pongut, boksit, karatesë, xhudos, takëando, fitnesit, futbollit femrave si dhe të gjitha kopshtet e fëmijëve të komunës sonë.

- 3 klubet eminente të futbollit gjilanas.
- klubi i futbollit (F)
- klubi i volejbollit Drita(F), kampione e Kosovës dhe fituese e kupave
- 5 klubet të karatesë, në mesin e tyre edhe fitues të medaljeve.
- klubi i boksit “Drita”(M), me dy kampionë të Kosovës
- klubi i ping pongut me dy kampione
- klubi i xhudos
- klubi i tekëando-s, dhe
- klubi i fitnesit.

Nga kjo listë të cilën kemi parashtruar, vërejmë se në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 15 klube aktive të qytetit, ndërsa numri total i atyre të cilët kanë qenë të ndërlidhur direkt ose indirekt me Panairin e Sportit në Gjilan i afrohet shifrës rreth 500 personave.

#### **Buxheti financiar i panairit të sportit 2016 ka qenë më sa vijonë :**

- Tenda për Klubet Sportive 580 €
- Shtypja e baneri si dhe materialit tjetër për panair 230 € si dhe
- Zërimi për këtë aktivitet 85 €

#### **Buxheti financiar i Njësisë së Sportit për 6 mujorin e parë të vitit 2016 është me sa vijonë:**

Në subvencion për projekte vjetore të klubeve si dhe për sportistit individual për përfaqësim të Komunës jashtë vendit janë ndarë gjithësejt 63119 €.

Të hyrat në Palestren e Sporteve si dhe në objektet tjera sportive në 6 mujorin e parë të këtijë viti janë gjithësejt 3866 €

Pra, ne vazhdimisht jemi duke punuar që të respektohen rregulloret për shfrytëzimin e hapësirave sportive, rritjen e gjenerimit të mjeteve, ngritjen dhe intensifikimi i komunikimit me të gjitha klubet sportive të komunës si dhe rregullimin e hapësirave në këto objekte sportive.